



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:008129
Datë: 09.01.2024
Numri i dokumentit: 05164273

C-IV-14-6827

Parashtruesi i kërkesës

F H, nga B, i përfaqësuar nga avokatët, N B, Sh R, B E dhe M L.
Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (NSH "Universal" në likuidim), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtari Gazmend Sylaj, me 9 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Ankesa hedhet si e papranueshme.**
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 30 tetor 2014 ankuesi, pranë DHPGJS, parashtron një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, sipas ankuesit, C-IV-13-1541/2014 datë 26 gusht 2014.

Kërkesa për rishikim është nënshkruar dhe vulosur nga ana e avokatit B E.

Me 19 shtator 2023, gjykata lëshoj një urdhër për përfaqësuesin e ankuesit, avokat B E, me anë të cilit ju kërkua që të parashtron kopjen e autorizimit për përfaqësim të ankuesit si dhe të parashtron kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit ndaj së cilës është parashtruar kërkesa për rishikim-ankesa.

Urdhri ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit, avokat B E, me 21 shtator 2023.

Gjer me datën e lëshimit të këtij aktvendimi urdhri nuk është përmbushur..

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim- ankesa konsiderohet e papranueshme.

Fillimisht, sipas nenit 36 paragrafi 2.5 i Ligjit për DHPGJS parashihet se një padi/ankesë konsiderohet e pranueshme nëse kërkesa/padia/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji.

Neni 33.1 i Ligjit për DHPGJS, parasheh se origjinali i çdo parashtruese, me rastin e dorëzimit në Gjykatë, duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues të autorizuar. Sipas kësaj dispozite, parashtruesi në këtë rast, duhet:

- a. që kërkesën/padinë/ankesën me rastin e parashtrimit pranë Gjykatës ta nënshkruaj personalisht, ose
- b. nëse kjo parashtruese parashtrohet dhe nënshkruhet nga ana e përfaqësuesit atëherë së bashku me kërkesën, si në rastin konkret të nënshkruar nga avokati B E, duhet të dorëzohet kopja e autorizimit për përfaqësimin e ankuesit.

Kërkesa për rishikim-ankesa, është nënshkruar nga përfaqësuesi i ankuesit, avokat B E, dhe se i njëjti edhe përkundër tentimeve të gjykatës me anë të urdhrit, nuk e ka përmbushur kushtin ligjor të paraparë sipas dispozitës ligjore si më lartë.

Andaj gjykata konsideron se kërkesa për rishikim-ankesa është parashtruar nga personit i pa-autorizuar.

Tutje, neni 36 paragrafi 2.6 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) parasheh se një padi/ankesë konsiderohet e pranueshme nëse është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.

Edhe përkundër tentimeve të gjykatës, me anë të urdhresës, nuk është përmbushur edhe ky kusht ligjor i paraparë sipas dispozitës ligjore si më lartë.

Nga gjitha arsyet gjykata nuk hyri në shqyrtim të çështjes, në merita.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar